



REPUBLIK E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO AKADEMIA E DREJTËSISË AKADEMIJA PRAVDE - ACADEMY OF JUSTICE			
Njësia, Org. Org. Jedin. Org. Unit.	01	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	684
Nr. Faqeve Br. Stranica No. Pages	03	Data Datum Date	18.08.2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Këshilli Drejtues / Upravni Odbor/ Governing Board

Nr. 01/ 684 /2025
Datë: 30/07/2025

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë,

Në bazë të nenit 10 paragrafi 2 i Ligjit Nr.05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë dhe nenit 3 paragrafi 1 nën paragrafi 1.10 i Rregullores nr. 02/2023 për plotësim ndryshimin e Rregullores Nr. 02/2017 për Punën e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë, në mbledhjen e mbajtur më datë 30 korrik 2025 merr këtë:

V E N D I M

I. Themelohen dy Komisione për hartimin e akteve nënligjore që rregullojnë statusin e veçantë të nëpunësve civilë të Akademisë së Drejtësisë, në pajtim me nenin 6, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë.

II. Përbërja e Komisionit të parë është si vijon:

1. Dardan Kadolli, gjyqtar GJAP– kryesues
2. Naim Abazi – Prokuror PSRK, anëtar
3. Argzon Muçaj, gjyqtar GJTHP– anëtar
4. Valmira Pefqeli – udhëheqëse e DTF, anëtare
5. Valmira Ahmeti – udhëheqëse e DSHLBN, anëtare

III. Përbërja e Komisionit të dytë është si vijon:

1. Shukri Jashari, prokuror PTHF– kryesues
2. Delushe Halimi gjyqtare GJSK – anëtare
3. Lulzim Aliaj, ekspert i jashtëm– anëtar
4. Bahri Hyseni, prokuror ZPSH – anëtar
5. Shehrie Leci – drejtoreshë e DSHLP, anëtare

IV. Komisionet kanë për detyrë hartimin e akteve nënligjore të ndara sipas përcaktimeve të këtij Vendimi.

V. Komisioni i parë ka për detyrë hartimin e këtyre akteve nënligjore:

1. Projekt-rregullorja për procedurën e pranimi
2. Projekt-rregullorja për vlerësimin e rezultateve në punë
3. Projekt-rregullorja për pezullimin nga marrëdhënia e punës
4. Projekt-rregullorja për përfundimin e marrëdhënies së punës
5. Projekt-rregullorja për themelimin e marrëdhënies së punës me kontratë për periudhë të caktuar
6. Projekt-rregullorja për orarin, pushimet dhe vijueshmërinë në punë
7. Projekt-rregullorja për disiplinën dhe ankesat
8. Projekt-rregullorja për transferimin
9. Projekt-rregullorja për vlerësimin e pamjaftueshmërisë profesionale në shërbimin civil
10. Projekt-rregullorja për planifikimin e personelit
11. Projekt-rregullorja për dosjen individuale dhe sistemin informativ të menaxhimit të burimeve njerëzore
12. Projekt-rregullorja për trajnimin

VI. Komisioni i dytë ka për detyrë hartimin e këtyre akteve nënligjore:

1. Projekt-rregullorja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në AD
2. Projekt-rregullorja për klasifikimin e vendeve të punës
3. Projekt-rregullorja për pranimin, vlerësimin dhe disiplinën e Drejtorit Ekzekutiv
4. Projekt-rregullorja për pagat, shtesat dhe kompensimet tjera të nëpunësve të AD-së, këshilltarëve dhe ekspertëve
5. Kodi i etikës për nëpunësit e AD-së
6. Projekt-rregullorja për shpenzimet e reprezentacionit
7. Projekt-rregullorja për udhëtimet zyrtare dhe shpenzimet e përfaqësimit
8. Projekt-rregullorja për përdorimin e automjeteve zyrtare
9. Projekt-rregullorja për përdorimin e telefonisë fikse dhe mobile

VII. Komisionet obligohen të hartojnë dhe dorëzojnë projekt-rregulloret në afatin më të shkurtër të mundshëm.

VIII. Komisionet janë të obliguara të bashkëpunojnë ngushtë me Drejtorin Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë dhe të sigurojnë që aktet të jenë të harmonizuara me legjislacionin në fuqi.

IX. Në rast nevojë, Komisionet mund të kërkojnë përkrahje shtesë profesionale ose juridike, me miratimin paraprak të Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë.

X. Kompensimi i anëtarëve të Komisionit bëhet në pajtim me nenin 38 të Ligjit për Pagat në Sektorin Publik, përjashtuar anëtarët që janë zyrtarë të Akademisë së Drejtësisë.

XI. Departamenti për Shërbime Ligjore dhe të Përgjithshme obligohet të ofrojë mbështetje administrative dhe teknike për punën e Komisioneve.

XII. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Fejzullah Rexhepi

Kryesues i Këshillit Drejtues
Akademia e Drejtësisë

Vendimi i dërgohet:

- Anëtareve të Komisioneve sipas pikës II dhe III të këtij Vendimi;
- Drejtorit Ekzekutiv të AD-së
- Arkivit të Akademisë së Drejtësisë